

## **RREGULLORE**

### **PËR PROCEDURAT E PARAQITJES DHE MIRATIMIT TË PLANIT TË INVESTIMEVE NGA OPERATORËT E TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR**

#### **KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1 *Autoriteti***

Kjo rregullore hartohet në zbatim të neneve 16 pika 12; 46 pika 12 dhe nenit 56 të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

##### **Neni 2 *Objekti***

Objekt i kësaj rregullore janë procedurat e paraqitjes dhe miratimit nga ERE, të planit të investimeve të OST dhe OSSH të gazit natyror.

##### **Neni 3 *Qëllimi***

Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktojë përmbajtjen dhe afatin e dorëzimit në kohë në ERE, të planit të investimeve të OST dhe OSSH, si dhe vlerësimin dhe analizën e kriterëve të aplikueshme dhe miratimin e tyre (ose rishikimin) nga ERE, për të siguruar që planet e investimit të jenë në përputhje me parimet e planifikimit me kosto më të ulët, rregullat dhe kërkesat e zbatueshme për sigurinë e operimit të rrjetit, cilësinë e shërbimit dhe sigurinë e furnizimit si dhe kërkesat e ENTSO-G lidhur me planifikimin e zhvillimit të rrjetit.

##### **Neni 4 *Zbatimi***

Kjo rregullore aplikohet për operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, të cilët kanë marrë nga ERE licencë për aktivitetet respektive.

##### **Neni 5 *Përkufizime***

Termet e përdorura në këtë Rregullore do të kenë kuptimet e mëposhtme:

1. “**Ligj**” do të thotë Ligji nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”.
2. “**Bordi**” do të thotë organi vendimmarrës i ERE, i emëruar sipas Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
3. “**ERE**” ose Enti Rregullator i Energjisë, do të thotë autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.
4. “**Aset**” do të thotë aktivi afatgjatë material, që përdoret nga operatorët e transmetimit

- dhe shpërndarjes së gazit natyror, dhe që i shërben realizimit të aktivitetit respektiv të licencuar.
5. **“Biznes”** do të thotë veprimtari e licencuar nga ERE për shërbimet e transmetimit, ose shpërndarjes së gazit natyror.
  6. **“Operator i rrjetit”** është Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe/ose Operatori i Sistemit të
  7. Shpërndarjes.
  8. **“Operator i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH)”** është personi juridik, i cili kryen funksionin e shpërndarjes dhe është përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar dhe, ku është e zbatueshme, ndërlidhjen me sisteme të tjera, si edhe për garantimin e mundësive afatgjata të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e gazit;
  9. **Investim** - Nënkupton shpenzimet strategjike kapitale të një të licencuari (OST ose OSSH) për të përmirësuar ose shtuar asetet, të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së licencuar.
  10. **Plani i Investimeve** - nënkupton shpenzimet kapitale të planifikuara për një periudhë rregulluese të një të licencuari (OST ose OSSH, sipas rastit), që merr parasysh parimet, plotëson kriteret dhe përmban elementët e parashikuara në Ligj dhe në këtë Rregullore. Planet e OST duhet të jenë në përputhje me TYNDP e cila është zhvilluar për një periudhë 10-vjeçare dhe i është dorëzuar ENTSO-G.
  11. **TYNDP**- do të thotë plani 10 vjeçar i zhvillimit të rrjetit pan-europian.
  12. **“ENTSO-G (European Network of Transmission System Operators for natural Gas)”** është Rrjeti Europian i Sistemit të Operatorëve të Transmetimit të Gazit.
  13. **ENC**- do të thotë Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.
  14. **Person** - do të thotë çdo person fizik ose juridik.
  15. **Licencë** - do të thotë një e drejtë që i jepet një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e gazit natyror, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 102/2015, *“Për Sektorin e Gazit Natyror”*.
  16. **I licencuar**-do të thotë një person, i pajisur me licencë për aktivitetet e transmetimit apo shpërndarjes së gazit natyror, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 102/2015, *“Për Sektorin e Gazit Natyror”*.
  17. **Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB)** - do të thotë vlera e asetëve fikse që zotërohen nga shoqëria dhe që përdoren për të kryer një nga veprimtaritë e licencuara në sektorin e gazit natyror.
  18. **Periudha Rregullatore** - do të thotë periudha gjatë së cilës tarifat e reja bëhen efektive dhe rregullohen/rishikohen sipas vendimit të marrë nga ERE.
  19. **Plani i Rrjetit 10 - vjeçar** - i referohet Planit 10- vjeçar të Rrjetit që do të përgatitet nga OST sh.a.
  20. **“Operator i Sistemit të Transmetimit (OST)”** është personi juridik, që kryen veprimtarinë e transmetimit dhe është përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjes dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e sistemit të transmetimit në një zonë të caktuar dhe, ku është e zbatueshme, ndërlidhjen e tij me sistemet e tjera, si dhe për garantimin e mundësive afatgjata të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për transportin e gazit **Ditë** në çdo rast në këtë rregullore do të kuptohet, ditë kalendarike.

Çdo term që përdoret, por nuk është përcaktuar në këtë Rregullore dhe është e përcaktuar në Ligj, do të ketë kuptimin e dhënë për atë term në Ligj, me përjashtim të rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe.

## **KAPITULLI II PLANET E INVESTIMEVE**

### **Neni 6**

#### ***Kërkesa të Përgjithshme të hartimit të planeve të investimeve***

Në hartimin e planeve të investimeve operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror do të mbajnë parasysh parimet e mëposhtme:

- a) Planet e investimeve do të jenë në përputhje me kërkesat e ligjeve, rregulloreve, metodologjive dhe të gjitha akteve nënligjore përkatëse, që rregullojnë studimet, projektimet dhe kryerjen e investimeve, përfshirë kërkesat për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, mjedisit dhe të sigurisë kombëtare. Planet e investimit duhet të jenë në harmoni me strategjitë kombëtare të zhvillimit të sektorit të gazit natyror.
- b) Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të sigurojë që plani i investimeve i dorëzuar të jetë në përputhje me parashikimet e planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit në Shqipëri dhe me planin e ENTSO-G pan-EU TYNDP, dhe në përputhje me informacionin e paraqitur në ENC për projekt /propozimet me interes të ENC.
- c) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit gjatë hartimit të planeve të investimeve duhet të marrin në konsideratë informacionin mbi parashikimin e kërkesës si dhe informacionin mbi planet e investimeve për kapacitetet e reja gjeneruese.
- d) Planet e investimeve duhet të hartohen në mënyrë që të sigurojnë efektivitet të lartë, kosto të ulët, përfshirë marrjen parasysh të masave për menaxhimin e kërkesës për gaz natyror.
- e) Planet e investimeve duhet të marrin parasysh marrëdhëniet që operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror kanë me pjesëmarrësit e tjerë të tregut, për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit të gazit natyror si dhe plotësimin e kushteve të sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me gaz natyror të klientëve.
- f) Planet e investimeve do të jenë të hapura për publikun duke i'u dhënë mundësinë të interesuarve përfshirë dhe institucionet e ndryshme shtetërore të japin komentet e tyre lidhur me këto plane.

### **Neni 7**

#### ***Përgjegjësitë e operatorëve***

1. OST dhe OSSH duhet të përgatisin planet e investimeve sipas periudhave të rregullimit dhe për çdo vit pasardhës në përputhje me Ligjin. ERE do të pranojë shtesa të planit të investimeve që janë paraqitur deri në gjashtë muaj pas paraqitjes së aplikimit të planit të investimeve, në mënyrë që të zvogëlojë barrën mbi OST dhe OSSH. Planet e investimeve do të shoqërohen me një relacion shpjegues, i cili do të përfshijë edhe paraqitjen tabelare dhe grafike të të dhënave referuese dhe një plan kohor zbatimi.
2. Operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror do të paraqesin në ERE raportin vjetor të zbatimit të planeve të investimeve të vitit paraardhës duke treguar ecurinë e investimeve të planifikuara dhe duke siguruar shpjegim për çdo ndryshim në plan. Raporti vjetor do të dorëzohet jo më vonë se 3 muaj pas përfundimit të periudhës në të cilën zbatohet plani i investimeve.

## Neni 8

### *Planet e investimeve për Operatorët e transmetimit të gazit natyror*

1. Plani 10 vjeçar i investimeve për operatorin e transmetimit të gazit natyror sipas nenit 46 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” duhet të hartohet në një plan 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit, në bazë të kërkesës dhe ofertës, i cili rishikohet deri më 31 Tetor të çdo viti, pasi të jetë konsultuar më të gjitha palët e interesit dhe të jetë mbajtur parasysh parashikimi ekzistues dhe i planifikuar i kërkesë-ofertës. Plani 10 vjeçar i zhvillimit të rrjetit duhet të :
  - a. të marrë në konsideratë informacionin për pjesëmarrësit e tregut të gazit natyror, si dhe informacionet për infrastrukturën kryesore të transmetimit që duhet të ndërtohet ose të përmirësohet gjatë 10 viteve të ardhshme;
  - b. të përmbajë të dhëna për të gjitha investimet e miratuara dhe të identifikojë investimet e reja, të cilat duhet të ekzekutohen në tri vitet e ardhshme;
  - c. të përcaktojë një afat kohor për të gjitha projektet e investimeve.
2. Në hartimin e planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit, OST-ja bën parashikime në lidhje me prodhimin, furnizimin, konsumin dhe shkëmbimin e gazit natyror me vendet e tjera, duke marrë parasysh planet e investimeve për rrjetet në vendet përreth, si dhe planet e investimeve për impiantet e depozitimit dhe rigasifikimit të GNL-së.
3. Plani 10 vjeçar i zhvillimit të rrjetit duhet të synojë:
  - a) Përmirësimin dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit të gazit, me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë së tij dhe sigurisë së furnizimit të vendit me gaz natyror.
  - b) Reduktimin e humbjeve teknike në rrjetin e transmetimit.
  - c) Krijimi /rritja dhe operimi i kapaciteteve të interkoneksionit me sistemet kufitare.
4. Në planifikimin e investimeve për të plotësuar synimet e mësipërme, operatori duhet të bazohet dhe të respektojë:
  - a) Kriteret e planifikimit dhe të zhvillimit të sistemit të transmetimit të përcaktuara në Kodin e Transmetimit si dhe procedurat e parashikuara për zhvillimin e sistemit të transmetimit.
  - b) Informacionet dhe të dhënat e siguruara nga operatorët/pjesëmarrësit e tregut të gazit natyror dhe përdoruesit e sistemit të transmetimit.
  - c) Kriteret e projektimit të elementëve kryesorë të rrjetit të transmetimit (tubacione dhe hapsira depozitimi).
  - d) Periudhën e ndërtimit apo të rehabilitimit të një objekti të gazit natyror.
  - e) Analizën e plotë të kosto përfitimit, sigurimin e efektivitetit të kostove të projektit dhe kostove të argumentuara, përfshirë plan investimesh të detajuar me afatet përkatëse (veprimtaria studimore – projektuese duke përfshirë vlerësimin e impaktit mjedisor).
5. Në planin e investimeve të parashikuar, operatori duhet të pasqyrojë listën e projekteve që do të zbatohë.
6. Plani i investimeve i paraqitur në ERE do të shoqërohet me relacione argumentuese lidhur me:
  - a. Metodologjitë e ndjekura për parashikimin e kërkesës, ngarkesës dhe ngarkesës maksimale sipas kushtit n-1 duke i paraqitur ato në mënyrë tabelare dhe grafike, që kanë diktuar ndërtimin apo rehabilitimin e rrjetit të transmetimit, të shpërndarjes, të

- pikave të lidhjes me rrjetin dhe pajisjeve rregulluese të presionit të gazit natyror, etj.
- b. Ndikimet e investimit në përmirësimin e kapaciteteve transmetuese, përmirësimin e performancës së sistemit, uljen e humbjeve teknike dhe çështje të tjera që lidhen me performancën e operatorit të transmetimit etj.
- c. Kostot, informacion i detajuar mbi humbjet, kërkesat për financim dhe burimet e tyre, periudhat e shlyerjes së investimeve dhe çështje të tjera.
- d. Analiza e plotë e përfitimit të kostos që vërteton efektivitetin e çdo projekti të planifikuar dhe justifikon kostot që lidhen me to.
- e. Implementim i detajuar i planit/skedulimit, i shoqëruar nga një studim fizibiliteti, studim për impaktin në mjedis, të drejtat pronësore dhe të shfrytëzimit.

## **Neni 9**

### ***Planet e Investimeve për Operatorin e shpërndarjes së gazit natyror***

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes harton në bazë të ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e gazit natyror”, planin e zhvillimit dhe investimeve të rrjetit, me qëllim garantimin e sigurisë, besueshmërisë, rregullsisë dhe cilësisë së furnizimit në sistemin e shpërndarjes. OSSH në haritmin e planeve të zhvillimit dhe investimeve merr në konsideratë dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe efijencës së energjisë.
2. Plani i zhvillimit dhe investimeve i rrjetit të shpërndarjes hartohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes për 10 vjet dhe do të përshtatet çdo vit për 10 vitet e ardhshme. Plani i zhvillimit dhe i investimeve do të përmbajë tregues afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. Treguesit afatshkurtër do të mbulojnë një periudhë prej 3 vjetësh, ato afatmesëm për një periudhë prej 6 vjetësh dhe ato afatgjatë një periudhë prej 10 vjetësh.  
Ky plan duhet të përmbajë investime që synojnë:
  - a. Rritjen e shkallës së sigurisë së sistemit të shpërndarjes së gazit natyror.
  - b. Zvogëlimin e humbjeve teknike dhe jo teknike në rrjetin e shpërndarjes së gazit natyror.
  - c. Mbajtjen e parametrave teknikë të furnizimit me gaz natyror të parashikuar në Kodin e Shpërndarjes.
  - d. Plotësimin dhe modernizimin e sistemit të matjes së gazit natyror në rrjetin e shpërndarjes.
3. Në hartimin e planeve të investimeve operatori duhet të bazohet dhe të respektojë:
  - a. Kriteret e planifikimit dhe të zhvillimit të sistemit të shpërndarjes të përcaktuara në Kodin e Shpërndarjes.
  - b. Studimi i ngarkesave ekzistuese dhe parashikimi i zhvillimit të ngarkesave në të ardhmen.
  - c. Kriteret e projektimit të elementëve kryesorë të rrjetit të shpërndarjes (menaxhimin, operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes,).
  - d. Periudhat kohore të zbatimit të investimit për ndërtimin apo rehabilitimin e një objekti.
4. Në planin e investimeve të parashikuara, operatori duhet të pasqyrojë listën e projekteve, që do të zbatohet.
4. Plani i investimeve shoqërohet me relacione argumentuese lidhur me:
  - a) Metodologjitë e ndjekura për parashikimin e kërkesës, ngarkesës dhe

ngarkesës pik sipas kushtit n-1 duke i paraqitur ato në mënyrë tabelare dhe grafike, që kanë diktuar ndërtimin apo rehabilitimin e nënstacioneve (TL/TM), kabinave të transformimit, pajisjeve rregulluese të tensionit, etj.

- b) Ndikimet e investimit në përmirësimin e kapaciteteve transmetuese, përmirësimin e performancës së sistemit, uljen e humbjeve teknike dhe çështje të tjera që lidhen me performancën e operatorit të transmetimit etj.
- c) Kostot, informacion i detajuar mbi humbjet, kërkesat për financim dhe burimet e tyre, periudhat e shlyerjes së investimeve dhe çështje të tjera.
- d) Analiza e plotë e përfitimit të kostos që vërteton efektivitetin e çdo projekti të planifikuar dhe justifikon kostot që lidhen me to.
- e) Implementim i detajuar i planit/skedulimit, i shoqëruar nga një studim fizibiliteti, studim për impaktin në mjedis, të drejtat pronësore dhe të shfrytëzimit.

### **KAPITULLI III**

## **PROCEDURAT E PARAQITJES DHE MIRATIMIT TË PLANIT TË INVESTIMEVE**

### **Neni 10**

#### ***Procedura e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve***

1. Një procedurë për miratimin e planit të investimeve fillon me paraqitjen e një kërkesë për miratim të planit të investimeve nga OST apo OSHEE së bashku me një plan të detajuar investimesh sipas dispozitave të parashikuara në nenin 8 dhe 9, si dhe shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje. I licencuari do të paraqesë planin e investimeve në ERE pasi t'a ketë konsultuar me palët e interesuara.
2. Nëse kërkesa për miratimin e planit të investimeve është bërë konform kushteve të përcaktuara në këtë Rregullore, Bordi i ERE merr vendim për fillim procedure të shqyrtimit të planit të investimeve.
3. Para marrjes së miratimit të planit të investimeve nga ERE, OST të marrë opinionin nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në lidhje me planin e investimeve që do të paraqesë.
4. ERE pasi shqyrton planin e investimeve dhe nëse e gjen atë në përputhje me kërkesat e lartpërmendura, e miraton tërësisht.

### **Neni 11**

#### ***Afatet e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve***

1. ERE ka përcaktuar afatet për paraqitjen dhe miratimin e planit të investimeve në kontekstin e aplikimit dhe miratimit të tarifave për veprimtaritë e ushtruara nga operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes në tregun e gazit natyror. Këta të fundit do të paraqesin në ERE planin e investimeve për vitin pasardhës në të njëjtën kohë me aplikimin për tarifë.
2. ERE publikon njoftimin për paraqitjen e planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga data e pranimit të aplikimit për marrjen e komenteve nga të interesuarit. Të interesuarit mund të paraqesin komentet e tyre brenda 15 ditëve nga publikimi.

3. ERE mund të kërkojë sqarime ose të bëjë pyetje lidhur me planin e investimeve të paraqitur nga aplikuesi, nga dita e paraqitjes së tij deri në miratim.
4. ERE mund të organizojë seanca dëgjimore me pjesëmarrjen e palëve të interesuara.
5. ERE shqyrton dhe merr vendim për miratimin e plotë të planit të investimeve para miratimit të tarifave të transmetimit apo shpërndarjes.

## **Neni 12**

### ***Kriteret për miratimin e planit të investimeve***

1. ERE mund të miratojë Planin e Investimeve në tërësi sipas përparësisë së projekteve. Informacioni i paraqitur në planin e investimeve përdoret nga ERE për të përcaktuar Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB), të veprimtarive të licensuara për aktivitetet respektive në sektorin e gazit natyror.
2. Në miratimin e planit të investimeve ERE merr në konsideratë:
  - a. Nëse plani përmirëson nivelin dhe cilësinë e shërbimit.
  - b. Nëse plani është në gjendje të përmirësojë dhe reduktojë humbjet teknike dhe joteknike.
  - c. Nëse plani përmban dhe reflekton masat për minimizimin e kostos duke përfshirë praktikat transparente dhe të drejta të blerjeve.
  - d. Nëse plani është mjaftueshmërisht i detajuar, i dokumentuar dhe konsiston në një shkallë të duhur fleksibiliteti në zbatim.
  - e. Nëse plani i investimeve ka analizuar dhe vlerësuar disa alternativa dhe ka argumentuar faktin se pse alternativat e tjera nuk janë përfshirë.
  - f. Nëse plani i investimeve është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të sektorit të gazit natyror.
  - g. Nëse plani është realizueshëm brenda afatit të përcaktuar.
3. Nëse ERE e sheh të arsyeshme mund të kërkojë kryerjen e një oponente për vlerësimin e aspekteve teknike dhe eficiencën ekonomike të investimit.

## **Neni 13**

### ***Njoftimi për Vendimin***

1. Brenda 3 ditëve kalendarike nga zbardhja e vendimit përfundimtar, ERE do të njoftojë operatorin e transmetimit apo të shpërndarjes së gazit natyror si dhe do t'i dërgojë atij një kopje të vendimit.
2. Vendimi i Bordit të ERE për miratimin e planit të investimeve për operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror publikohet në Fletoren Zyrtare.
3. Brenda 7 ditëve nga marrja e vendimit të Bordit të ERE-s, i licensuari ka të drejtë të paraqesë kërkesën për rishikim në ERE konform Rregullores së funksionimit, organizimit dhe procedurave të ERE.

**KAPITULLI IV  
DISPOZITA TË TJERA**

**Neni 14**  
*Informacioni konfidencial*

Në rast se ndonjë operator pretendon se plani i investimeve të tij përmban një numër informacionesh dhe të dhënash, që ai i konsideron konfidenciale, ai do t'i shënojë si konfidenciale kur paraqet planet e investimeve dhe të tilla informacione dhe të dhëna do të do të vlerësohen nga ERE-s, nëse janë të tilla sipas rregullave dhe procedurave që aplikohen për këto lloj informacionesh dhe të dhënash.

**Neni 15**  
*Ankimi gjyqësor*

Kundër Vendimit të Bordit të ERE-s, për miratimin ose jo te planit të investimeve, operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror, mund të bëjnë ankim në gjykatë brenda 45 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare.

**Neni 16**  
*Amendimi i Rregullores*

Kjo Rregullore është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s, në përputhje me Rregullat e organizimit dhe funksionimit dhe procedurave të ERE-s.

**Neni 17**  
*Hyrja në fuqi*

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Neni 18**  
**Dispozita përfundimtare**

Procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror u miratua nga Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 18, datë 10.01.2018.

**Shtojce 1:** Tabela e Investimeve për vitin 2018

<b>Përshkrimi i Grupit të Aseteve (në përputhje me Listën e Llogarive)</b>	<b>Numri i Llogaris e</b>	<b>Koha e pritshme e vënies në punë</b>	<b>Vlera e pritshme e Kapitalizuar (për t'u përfshirë në RAB)</b>	<b>Jetegjatesia e pritshme</b>	<b>Amortizimi vjetor i pritshem</b>